



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0506

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

S (R)D, Kraljevë, Republika e Serbisë, i përfaqësuar nga **Projekti për Ndhimë Juridike falas, Graçanicë**

Kundër

E paditura

NSH "Dubrava" (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2455 të datës 11 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 tetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2455 të datës 11 gusht 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 10 prill 2014, përmes postës paditësi e dërgon në DHPGJS një ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ036-0382 të datës 13 mars 2014, me të cilën kërkesa e tij e datës 10 janar 2014, për pagesën e pagave të pa paguara për periudhën dhe shumën e paspecifikuar refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi pretendon se ishte punëtor i NSH-së "D" dhe për të nuk është e qartë pse nuk është marrë në konsideratë kërkesa e tij. Paditësi e kundërshton konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar, duke pohuar se në rastin e tij janë shkelur të drejtat e përcaktuara me ligj, dhe me neni 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Tutje në ankesë ai pohon se kërkesa e tij për paga duhet të merret në konsideratë, pasi ka mbështetje ligjore. Me ankesë paditësi e ka dorëzuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Letërnjoftimit, një Aktvendim të marrëdhënies së punës të datës 19.11.1995, dhe një kopje të Librezës shëndetësore.

Me datë 31 janar 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit i ka vlerësuar drejtë rrethanat faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat material kur e ka refuzuar kërkesën. Tutje AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të tregoj se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur. AKP-ja konsideron se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që Ankuesja ka dështuar të sjell prova se këtë kërkesë e ka paraqitur brenda 3 viteve në Gjykatën kompetente, dhe po ashtu kërkesa është edhe e pa bazuar, pasi që nuk është mbështetur me asnjë provë materiale.

Me datë 23 shkurt 2022, paditësi e pranoi mbrojtjen në ankesë të AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje të mëtejme.

Me datë 11 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-2455 e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në bazë të nenit 42.2 të LDHP, nenit 7 të

LPK-së, paditësi e kishte barrën e provës, ai ka dështuar të ofroj prova edhe në procedurën e likuidimit, por edhe në Gjykatë se ka ofruar shërbime pune për NSH-në për periudhën dhe shumën e pa përcaktuar, dhe se NSH-ja nuk detyrohet ti kompensoj pagat e pretenduara. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësi në bazë të nenit 40.1.6.1 dhe 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësi nuk e ka dëshmuar të drejtën e tij në paga, andaj për këtë arsye, ankesa e tij është refuzuar si e pa bazuar dhe është vërtetuar Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 05 shtator 2022, përmes postës paditësi e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-2455 të datës 11 gusht 2022, dhe kërkon që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar. Në ankesë ai pohon se për pagat të cilat i kërkon prej NSH-së për periudhën 1999 – 2013, ai ka dorëzuar me ankesë, kopjen e Letërnjoftimit, kopjen e Aktvendimit mbi marrëdhënien e punës, kopjen e Librezës shëndetësore, të cilat nuk janë marrë në konsideratë. Paditësi në ankesë ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar ka të meta të shumta për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet, e posaçërisht dispozitiv i Aktgjyqimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna në Aktgjykim, ose nuk ka fare arsye për faktet vendimtare. Tutje paditësi pretendon se Shkalla e I-rë ka qenë dashur ta anuloj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit e jo të paraqes arsye kontradiktore për faktet vendimtare të kësaj çështje kontestimore. Arsyet e refuzimit të kërkesës janë të pa qarta dhe kontradiktore dhe rrjedhimisht për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike është e shkelur edhe e drejta materiale. Tutje paditësi pohon se Shkalla e I-rë nuk i ka marrë për bazë dispozitat materiale nga neni 221 deri 225 të Ligjit të Punës së Bashkuar, duke pohuar se e paditura ka qenë e detyruar të bëjë pagesën e pagave minimum tri vite mbrapa duke llogaritur nga momenti i fillimit të procedurës së likuidimit në vitin 2013. Paditësja në ankesë konsideron se me Aktgjykimin e ankimuar janë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara me nenin 24 paragrafi 2 të Kushtetutës dhe me nenin 1 protokollin 1 të Konventës Evropiane për të Drejta dhe Liri të Njeriut. Tutje ai pohon se konstatimet e Autoritetit të Likuidimit janë të gabuara dhe kontradiktore dhe rrjedhimisht gabimisht është aplikuar edhe e drejta

materiale. Në ankesë paditësi i referohet një rasti nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0151.

Me datë 04 nëntor 2022, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 10 janar 2014, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit për pagesën e pagave të pa paguara për periudhën dhe shumën e papërcaktuar. Kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e refuzon ankesën e paditësit dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar prova se ka kryer shërbime pune për NSH-

në për periudhën e pa përcaktuar, ndërsa nuk jep asnjë konstatim lidhur me çështjen e parashkrimit të kërkesës.

Paditësi me ankesën në shkallën e dytë, ka pohuar se ai kërkon paga prej vitit 1999-deri 2013, mirëpo prapë nuk cakton ndonjë shumë konkrete.

Duke marrë parasysh faktin se paditësi kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit e ka dorëzuar me 10 janar 2014, atëherë del që pagat e kërkuara nga paditësi për muajt janar 2011 deri në muajin dhjetor 2013, nuk janë parashkruar pasi që ende nuk ka kaluar afati 3 vjet i parashkrimit. Andaj për këtë pjesë të kërkesës Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa është parashkruar. Ndërsa pagat e tjera të kësaj periudhe nga viti 1999 e deri në muajin dhjetor 2011 janë parashkruar, pasi që është e qartë se paditësi ka dështuar të ofroj prova se këto paga i ka kërkuar më herët në Gjykatën Kompetente. Andaj për këtë pjesë të kërkesës konstatimi i Autoritetit të Likuidimit për çështjen e parashkrimit, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e saj në Shkallën e I-rë ka dorëzuar vetëm vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Librezës shëndetësore dhe një Aktvendim nga marrëdhënia e punës të datës 19.11.1995, ndërsa me ankesën e tij në Shkallën e II-të, ai nuk ka dorëzuar asnjë provë tjetër materiale. Këto dëshmi të ofruara nga paditësi, nuk janë të mjaftuara që atij ti njihet e drejta në paga të pa paguara për periudhën 1999 deri në 2013.

Paditësi, në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së dhe nenit 7 të LPK-së e ka pas barrën e provës, ai ishte i detyruar të dorëzoj prova se ka kryer shërbime pune për NSH-në në periudhën e cekur, të dorëzoj prova për lartësinë pagës mujore, dhe prova për mënyrën e përlllogaritjes së kërkesës totale që ai nuk e ka përcaktuar. Andaj me të drejtë ankesa e tij është refuzuar nga Shkalla e I-rë e DHPGJS-së.

Ankuesi ka të drejtë të kërkoj paga prej NSH-së, vetëm në raste kur ai vërteton me prova që ka kryer shërbime pune për NSH-në, dhe ai nuk mund të kërkoj paga për punën që nuk e ka kryer në NSH. Një qëndrim të tillë ligjor Kolegji e

Apelit e ka marrë në disa raste në jurisprudencën e tij, AC-I-15-0294, AC-I-16-0189, AC-I-16-0286, AC-I-21-0095, dhe në shumë raste të tjera.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me Aktgjykimin e ankimuar nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi nuk ka përcaktuar shumën e kërkesës për paga, andaj gjykata ndaj tij nuk ka dorëzuar vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore për procedurën ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 05 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
